



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 10

Prishtinë, më 08.04.2015 ora: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-II

Procesverbal

i mbledhjes së komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Xhevahire Izmaqi, Alma Lama, Shqipe Pantina, Zafir Berisha.

Mungoi: Kujtim Paçaku, Jelena Bontic dhe Pal Lekaj

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Në mbledhje morën pjesë: anëtarët e këshillit të pavarur mbikëqyrës për shërbimin civil të Kosovës dhe sindikata e RTK-së.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për vitin 2014;**
- 4. Takimi i Komisionit me përfaqësuesit e Sindikatës së RTK-së;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje me një përjashtim, në procesverbalin e dt. 25 mars 2015. znj. **Alma Lama** ka pasur vërejtje dhe ka kërkuar që në procesverbal të inkorporohet fjalja e saj si në vijim: Rreth formimit të grupit punues dhe vendimit të komisionit për nismën e plotësimit ndryshimit të Ligjit për RTK-në, ajo u deklarua se nuk ka votuar për plotësim - ndryshimin e ligjit për RTK-në dhe ka shpreh mendimin se nuk ka nevojë që ligji të ndryshohet dhe se propozimet e bordit dhe menaxhmentit të RTK-së për plotësim - ndryshimin e ligjit i konsideron të paarsyeshme.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për vitin 2014;

Lulzim Aliaj - Kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, prezantoi raportin vjetor 2014, ai prezantoi punën 1 vjeçare të Këshillit, dhe e njoftoi komisionin për numrin e ankesave të shërbyesve civil, dhe rritjen e numrit të ankesave në vitin 2014, për mënyrën e vendosjes së ankesave dhe sfidën që këshilli ka për mos zbatimin e vendimeve nga ana e institucioneve qendrore dhe lokale dhe lidhur me këtë kërkuan mbështetjen e Kuvendit për zbatimin e vendimeve të këshillit nga institucionet. Ata e njoftuan Komisionin edhe për punën, përkatësisht monitorimin e shërbyesve civil jashtë Kosovës, në ambasada e konsullata.

Alma Lama – tha se raporti është teknik me shifra të vendimeve, raporti duhet të ishte me një analizë me të thellë, të detajizuar, qoftë të implementimit të vendimeve të këshillit, apo edhe llojit të ankesave të zyrtarëve publik.

Ajo kërkoi shpjegim lidhur me:

- shtimin e numrit të ankesave në këshill në vitin 2014 në krahasim me vitet e mëparshme;
- me kthimin e punëtorëve të korruptuar në vendet e punës;
- për numrin e vendimeve të këshillit të anuluar nga gjykatat;
- dhe çfarë masash disiplinore janë marrë ndaj zyrtarëve drejtues të institucioneve të cilët nuk kanë zbatuar vendimet e këshillit.

Sadri Ferati – moszbatimi i vendimeve të këshillit dhe rritja e numrit të ankesave nuk është lajm i mirë dhe për këtë që në mbledhjen e radhës, do të propozojmë të jetë pikë e rendit të ditës diskutimi për ndryshimin e Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës tek dispozitat për masat disiplinore ndaj zyrtarëve që nuk i zbatojnë vendimet e këshillit, lidhur me këtë ai pyeti: se cili është vlerësimi i këshillit për legjislacionin në fuqi, a kanë vërejtje apo sugjerime, dhe cilat janë veprimet e këshillit sipas ex-officio, si formohen panelet brenda këshillit për shqyrtim të ankesave dhe kërkoi një raport shtesë për vendimet e këshillit të vërtetuara apo anuluar nga gjykatat.

Xhevahire Izma - pyeti: cilat janë raportet e këshillit me sekretariatit e këshillit, si korrespondojnë, a mendoni se ka kolizion të ligjeve, është shqetësuese tek klasifikimi i vendeve të punës, disproporcioni i ankesave të gjinisë femërore karshi ankesave të gjinisë mashkullore si e shpjegoni këtë.

Shqipe Pantina - raporti është i mirë edhe pse ka hapësirë për plotësim, meqë në raport nuk ishte inkorporuar çështja e ushtruesve të detyrës së zyrtarëve menaxhues, ajo pyeti cilat janë të gjeturat lidhur me këtë, gjatë procesit të monitorimit, çfarë rekomandimi keni për rastet kur skadon afati për zyrtarët si ushtrues të detyrës, çfarë duhet të bëjë Kuvendi që të zbatohen vendimet dhe rekomandimet e këshillit, a adresohen drejtpërdrejt në MAP.

Zafir Berisha - lidhur me moszbatimin e vendimeve të këshillit, pyeti çka duhet komisioni të bëjë për tejkalimin e situatës, ngase kthimi në vendin e punës ndikon edhe në shpenzime buxhetore.

Zenun Pajaziti – ku ka arritur përpjekja për ndryshimin e gjendjes rreth logjistikës, ku janë trendet tek gjendja e shërbimit civil dhe a mendoni se duhet ndryshuar ligji në fuqi?

Lulzim Aliaj - rreth kthimit në punë të zyrtarëve të korruptuar, këshilli nuk merret me çështjen se a janë të korruptuar apo jo, sepse për këtë është kompetent organi i akuzës, por këshilli merret me çështjen se a ka shkelje procedurale nga aspekti administrativ.

Sa i përket vendimeve të gjykatave siç e dini, gjykatat në vitin 2014 kanë shqyrtuar lëndët e vitit 2010, ndërsa kur është fjala për tri vendimet e vitit 2014, ato janë vendime për shtyrje të ekzekutimit.

Sa i përket rritjes së numrit të ankesave kjo është rezultat i rritjes së vetëdijësimit të nëpunësve civil për të drejtat e tyre, d.m.th të dhënat nuk janë teknike, por pasqyra reale.

Është shqetësuese mos shqiptimi i masave disiplinore ndaj zyrtarëve drejtues të institucioneve të cilët nuk i zbatojnë vendimet e këshillit, këshilli e kryen mandatin me nxjerrjen e vendimit dhe detyrë tjetër pas kësaj është njoftimi i Kuvendit dhe Kryeministrit për vendimin e nxjerrë.

Lidhur me formimin e paneleve (grupeve shqyrtuese të ankesave) brenda këshillit, këto panele formohen në fillim të vitit kalendarik dhe secili panel merret me shqyrtimin e ankesave sipas radhës.

Konstatim: pas diskutimeve, Komisioni unanimisht miratoi Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil dhe nxori rekomandim si vijon:

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 67 dhe 72, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 08.04.2015, shqyrtoi Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2014, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2014.
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 19 të Ligjit nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ia paraqet raportin vjetor të punës Kuvendit të Kosovës.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 08.04.2015, shqyrtoi Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2014 dhe vlerësoi se Raporti vjetor i punës është në pajtim me nenin 19 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

4. Takimi i Komisionit me përfaqësuesit e Sindikatës së RTK-së;

Zenun Pajaziti - i njoftoi sindikalistët që në cilësinë e kryetarit të komisionit është caktuar të raportojë për MSA lidhur me zhvillimet në RTK, si për çështjen e financimit të RTK-së dhe interesimin e Komisionit Evropian që sa më shpejt të gjendet mënyra e mëtutjeshme e financimit të RTK-së, ai gjithashtu i njoftoi sindikalistët edhe për rekomandimet që Kuvendi i Kosovës i ka nxjerr për RTK-në.

Kërkesa e kryetarit të komisionit për sindikalistët ishte që të fokusohen vetëm për çështjet që bien në përgjegjësinë e sindikalistëve dhe të mos i kalojnë kompetencat e tyre, duke mos përfshiruar përkrahjen për të drejtat e tyre, me arsyen që për çështje të tjera që janë për diskutim dhe shqyrtim komisioni do të informohet në takimin e radhës kur edhe do të ftohet bordi i RTK-së për të raportuar për punën një vjeçare me raport vjetor.

Përfaqësuesit i sindikatës së RTK-së - e njoftuan komisionin për problemet në RTK, duke filluar nga menaxhmenti dhe Bordi i RTK-së që nuk i përmbushin obligimet ligjore, për shqetësimet në rekrutimin e punëtorëve në RTK, se RTK-ja është e zhytur në borxhe duke bërë lidhjen e kontratave që janë në kundërshtim me procedurat e prokurimit, dhe nga borxhet e RTK-së pasojat do ti vuajnë punëtorët. Duke bërë lidhjen e kontratave me producentë të pavarur thirren në emër të dispozitave të ligjit në fuqi, sipas së cilave dispozita RTK-ja mund të lidh kontrata nga 15%, por jo më shumë se 20%. Për këto parregullsi njësjia e krimeve ekonomike ka filluar hetimet.

60% e buxhetit të RTK-së ndahet për paga dhe mëditje, ku drejtori gjeneral ka 10 këshilltar me një mijë euro pagë mujore. Në RTK ka të punësuar mbi 900 punëtor, nga të cilët 340 janë punësuar në 18 muajt e fundit.

Vlen të theksohet se në këtë numër të të punësuarve nuk janë të përfshirë 60 punëtorë të tjerë të cilët janë të punësuar me kontratë mbi vepër për 10 vite.

Komisioni disiplinor merret vetëm me punëtorët të cilët janë pjesëtar të sindikatës së RTK-së.

Drejtori menaxhues i RTK-së është anëtar i komisionit disiplinor në shkallë të parë dhe të dytë.

Vendimet e menaxhmentit të RTK-së për përjashtimin e punëtorëve nga puna janë kërcënim gjithashtu edhe për punëtorët tjerë.

5. Të ndryshme

Zafir Berisha - propozoi që në mbledhjen e radhës të thirren edhe sindikata tjetër e RTK-së dhe ky propozim u miratua nga komisioni.

Zenun Pajaziti - e njoftoi komisionin për një ftesë që asociacioni i komunave i ka bërë komisionit për organizimin e një tryeze pune për nismën e plotësim - ndryshimit të ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.

Shqipe Pantina – pati tri kërkesa, që të fillohet me formimin e grupeve punuese nga radhët e anëtarëve të komisionit për fillimin e monitorimit të ligjeve sipas planit të punës së komisionit, që mbledhjet e komisionit të caktohen sipas rregullave të rregullores së punës së Kuvendit dhe në takimet kur kryetari i komisioni thirret në cilësinë e kryetarit të komisionit, të përfaqësohet edhe me një anëtar të komisionit nga radhët e opozitës.

Mbledhja përfundoi në ora: 13:15.

Përgatitur nga :

Njësjia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Zenun Pajaziti**
